



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurorja e Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykesues II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 2 janar 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për të Ndryshuar
Kalendarin e Seancave për Muajt Janar dhe Shkurt 2024**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(4)(c), 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 116(1) dhe (4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 22 dhjetor 2023, Mbrojtja e Kadri Veselit ("Mbrojtja e Veselit") paraqiti një mocion ku kërkonte një ndryshim në kalendarin e seancave të ardhshme ("Kërkesa")¹. Mbrojtja e Veselit i referohet kalendarit aktual i cili parashikon që seancat të mbahen në datat 15-18 janar, 23-25 janar, 29-31 janar 2024 dhe më tej, në 1 shkurt, 12-15 shkurt, 20-22 shkurt dhe 26-28 shkurt 2024². Për shkak të vdekjes së papritur të bashkëmbrojtësit vetëm pak kohë më parë dhe rekrutimit të mëpasshëm të mbrojtësit të ri, Mbrojtja e Veselit kërkon që të anulohen seancat e caktuara për datat 29-31 janar, 1 shkurt dhe 12-15 shkurt 2024. Sipas Mbrojtjes së Veselit, kjo do t'i jepte mbrojtësit të ri kohën e nevojshme për t'u njohur me provat³.

2. Në mbështetje të kësaj Kërkesë, Mbrojtja e Veselit i referohet nenit 21(4)(c) dhe (f)⁴, si dhe jurisprudencës së tribunalëve të tjerë penalë.⁵ Mbrojtja e Veselit argumenton se kalendarit mund t'i bëhen ndryshime të arsyeshme kur vërtetohet se mungesa e mbrojtësit do të kishte një ndikim të pashmangshëm në paraqitjen e provave dhe argumenteve të Mbrojtjes⁶. Mbrojtja e Veselit parashtron se Kërkesa

¹ F02032, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për të Ndryshuar Kalendarin e Seancave për Muajt Janar dhe Shkurt 2024*, 22 dhjetor 2023, konfidenciale, paragrafët 1-2, 5, 19, 22.

² Mesazh elektronik dërguar nga Njësia e Administrimit të Gjykatës palëve dhe pjesëmarrësve në orën 08:31 të datës 10 nëntor 2023 (dërguar Trupit Gjykues II po atë ditë, në orën 08:34).

³ Kërkesa, paragrafët 2-3.

⁴ Kërkesa, paragrafi 11.

⁵ Kërkesa, paragrafi 13.

⁶ Kërkesa, paragrafi 13.

përmban një shtyrje prej vetëm dy javësh dhe se koha e kërkuar është e nevojshme për të siguruar garantimin e të drejtave themelore të të akuzuarit.⁷

3. Mbrojtja e Veselit parashtron se tri ekipet e tjera të mbrojtjes e mbështesin këtë kërkesë dhe se Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") ka treguar në korrespondencën *inter partes* se nuk ka ndonjë qëndrim të caktuar në lidhje me Kërkesën "me kusht që koha e humbur në kalendarin e seancave të mos cenojë mundësinë e ZPS-së për të paraqitur provat dhe argumentet e veta apo të jetë pjesë e ndonjë vlerësimi dëmtues për ecurinë e gjykimit"⁸. Mbrojtësi i Viktimave e mbështet kërkesën⁹.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Neni 21(4)(c) parashikon që të akuzuarit t'i garantohet e drejta për të pasur kohën dhe kushtet e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tij/saj. Neni 21(4)(d) parashikon që i akuzuari ka të drejtën për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme. Sipas nenit 40(2), Trupi Gjykses mund të miratojë procedura dhe modalitete që janë të nevojshme për të mundësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit gjyqësor.¹⁰

III. DISKUTIM

5. Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa është bërë në kohën e duhur pasi është paraqitur brenda një kohe të shkurtër nga vdekja e bashkëmbrojtësit dhe lejon kohë të mjaftueshme deri në datat e seancave përkatëse.

⁷ Kërkesa, paragrafët 15, 18.

⁸ Kërkesa, paragrafët 4, 15; F02032/A01, Prokurorja e Specializuar, *SHTOJCA 1 e Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit për të Ndryshuar Kalendarin e Seancave për Muajt Janar dhe Shkurt 2024 ("Shtojca 1")*, 22 dhjetor 2023, konfidenciale, faqja 3.

⁹ Shtojca 1, faqja 2.

¹⁰ *Shih gjithashtu* rregullën 116(1) dhe (4).

6. Trupi Gjykses rikujton se Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit përcakton detyrimin për praninë në gjykatë ose të kryembrojtësit ose të bashkëmbrojtësit dhe Trupi Gjykses, në parim, nuk e shtyn procesin për shkak të mungesës së njërit prej tyre.¹¹ Për më tepër, Trupi Gjykses vëren se ndryshimi i kalendarit, kërkuar prej Mbrojtjes së Veselit, do të sillte probleme të qenësishme për një sërë dëshmitarësh të rëndësishëm të ZPS-së dhe do të shkaktohte vonesa në procesin gjyqësor. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se miratimi tërësor i kërkesës do të ishte i paarsyeshëm. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vëren se Z. Veseli vijon të përfaqësohet nga dy mbrojtës me të drejtë paraqitjeje, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha fazat përkatëse të procesit.

7. Megjithatë, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e Veselit ka parashtruar arsye të vlefshme për disa ndryshime të kufizuara të kalendarit të seancave për të siguruar që bashkëmbrojtësi i ri të mund të njihet me lëndën dhe që Mbrojtja e Veselit të ketë mundësi për t'u përgatitur në mënyrë efikase për pyetjen e dëshmitarëve të palës tjetër, pavarësisht nga rrethanat e përcaktuara më sipër. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se sipas Mbrojtjes së Veselit, as ZPS-ja, as ndonjë palë apo pjesëmarrës tjetër nuk e ka kundërshtuar Kërkesën.

8. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses e gjen me vend të anulojë vetëm seancat e caktuara në datat 12-15 shkurt 2024 dhe t'i mbajë seancat e tjera sipas kalendarit të vendosur më parë.

IV. KLASIFIKIMI

9. Trupi Gjykses vëren se Kërkesa është paraqitur si dokument "konfidencial" megjithëse për këtë klasifikim nuk është dhënë asnjë arsye. Për rrjedhojë, në pajtim me rregullën 82(3) dhe (5), Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Veselit të paraqesë

¹¹ F01226/A01, Trupi Gjykses, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, paragrafi 130.

një variant të redaktuar publik të Kërkesës ose të kërkojë riklasifikimin e saj si dokument “publik” brenda ditës së martë, 9 janar 2024.

V. VENDIM

10. Për arsyet sa më sipër, Trupi Gjykes:

- a) **MIRATON** Kërkesën, pjesërisht;
- b) **ANULON** seancat e caktuara për datat 12-15 shkurt 2024 dhe
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen e Veselit të paraqesë një variant të redaktuar publik të Kërkesës ose të kërkojë riklasifikimin e saj si dokument “publik” brenda ditës së martë, 9 janar 2024.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E martë, 2 janar 2024

Në Hagë, Holandë